



Akademia e Drejtësisë, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6 A paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor dhe Vendimit Nr. 01/467/2025 i datës 08.05.2025 të Këshillit Drejtues, publikon këtë:

Shpallje Publike

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Akademia e Drejtësisë synon krijimin e një qasje të barabartë për të gjithë të interesuarit për aplikim.

I. Titulli i pozitës së punës:

Anëtar i Këshillit Programor – një (1) pozitë

II. E drejta për propozim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor:

- Kryetarët e Gjykatave;
- Kryeprokurorët;
- Drejtuesit e institucioneve tjera.

III. Të drejtë aplikimi kanë personalisht:

- Gjyqtarët;
- prokurorët dhe
- profesionistët ligjorë.

IV. Kriteret e aplikimit:

Kandidati për anëtar të Këshillit Programor duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

- Kompetencë të dëshmuar në një fushë të caktuar të së drejtës ose në sistem të drejtësisë;
- Pesë (5) vite përvojë profesionale në sistemin e drejtësisë;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e trajnimit gjyqësor.

V. Dokumentet e kërkuara për aplikim:

- CV-në;
- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit që vërteton pozitën e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështeten me një nga dokumentet si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale ose

pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;

- Dëshmi për përvojë në fushën e trajnimit gjyqësor.

VI. Mandati i anëtarit të Këshillit Programor:

Katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

VII. Pagesa e anëtarit të Këshillit Programor:

Anëtari i Këshillit Programor kompensohen në lartësinë prej shtatëdhjetë (70%) të kompensimit të anëtarit të Këshillit Drejtues, në bazë të takimeve të mbajtura dhe pjesëmarrjes në to.

VIII. Mënyra e nominimit apo aplikimit:

Nominimi apo aplikimi mund të bëhet në njërin nga mënyrat si vijon:

- Përmes postës;
- Përmes e-mailit: arianit.shabani@rks-gov.net;
- Dorëzimit fizik në Akademi.

IX. Afati i fundit për nominim apo aplikim:

Dokumentet e aplikimit sipas pikës IV të kësaj shpalljeje publike duhet të dorëzohen deri më datë 26.05.2025.

Qëllimi kryesor i këtij procesi është plotësimi i përbërjes së plotë të Këshillit Programor me anëtarë në pajtim me nenin 15, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, i cili përcakton: “Këshilli Programor përbehet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues nga radhët e Gjyqtarëve, Prokurorëve të Shtetit dhe ekspertëve tjerë”.

Për çdo informatë shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 68 004 / +383 (44) 89 00 89 ose në email adresën: arianit.shabani@rks-gov.net

Shënim: Për informata më të detajuara rreth Këshillit Programor mund të konsultoni Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Rregulloren Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor, si dhe Rregulloren Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.

Klikoni mbi vegzat më poshtë për t'u lidhur në mënyrë elektronike me aktet ligjore.

[Ligji për Akademinë e Drejtësisë](#)

[Rregullore Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor](#)

[Rregullore Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë](#)